



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vitisë (K.V), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Klasifikimi i shpenzimeve është bërë në kategori ekonomike jo adekuate në vlerë 134,957€.
- A2 Llogaritë e arkëtueshme janë mbivlerësuar për 32,761€ për tri prona të cilat janë në pronësi të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të cilat sipas kornizës ligjore janë të liruar nga tatimi në pronë.
- B1 Detyrimet kontigjente janë mbivlerësuar për 7,778€, ku një padi ishte përfshirë gabimisht në regjistrin e detyrimeve kontigjente.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Vitisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Komuna kishte dhënë subvencione në kundërshtim me Rregulloren për Subvencionimin e OJQ-ve dhe me kriteret e përcaktuara në Thirrjet Publike.
- A4 Komuna ka përdorë fondet e projekteve për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore.
- B2 Pasuritë në vlerë 2,348,431€, ishin të regjistruara si pasuri në vijim derisa është dashur të jenë të regjistruara si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohet zhvlerësimi konform shkallëve të caktuara me rregullore.
- B3 Komuna kishte të angazhuar 80 zyrtarë me kontrata për shërbime të veçanta, dhe për ta nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.
- B4 Komuna ka kryer pagesa me vonesë në vlerë prej 208,111€, si dhe ka pasur pagesa direkte nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore për paga jubilarë dhe përcjellëse në vlerë prej 852,623€, prej të cilave 176,550€ ishin për shpenzime procedurale të gjykatës/përmbarrimit dhe kamata.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vitisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vitisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vitisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vitisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vitisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: moszbatim i procedurave të duhura të menaxhimit të kontratave përmes E-prokurimit, menaxhimit të arkëtueshmeve, mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV, mangësi në dhënien e subvencioneve, keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate, si dhe dobësitë në menaxhimit të pasurive përfshirë edhe kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimit të fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, gjashtë (6) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Përmes pagesave direkte nga Thesari, nëntë (9) transaksione në vlerë 134,957€ të paguara për Pagat jubilarë dhe shujta, janë realizuar gabimisht nga kategoria ekonomike investimet kapitale (63,220€), mallra e shërbime dhe komunalit (41,191€), si dhe nga subvencionet (30,546€).

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimit të obligimeve.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PFV

Gjetja Neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 10 në pikën 10.1 përcakton se: 1. Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: 1.1. institucioneve publike të Republikës së Kosovës.

Llogaritë e arkëtueshme LI/A janë mbivlerësuar për 32,761€ për tri prona të cilat janë në pronësi të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të cilat sipas kornizës ligjore janë të liruara nga tatimi në pronë. Ndërsa, në pesë raste (mostra) të testuara për taksa në biznes në shumë totale 8,717€ nuk kemi arritur të sigurojmë dëshmi si fatura, kartela financiare, etj, dhe të cilat datojnë si të arkëtueshme të bartura që nga viti 2010.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë. Po ashtu, komuna nuk ka një bazë të të dhënave ku mbahen shënimet e të gjitha LI/A.

Ndikimi Prezantimi i LI/A në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e LI/A.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe të sigurohet se prezantimi i tyre në PFV është i saktë. Po ashtu, të ndërmerren veprimet e nevojshme për obligimin e tatimit në pronë për objektet në pronësi të institucioneve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV

Gjetja Rregulla MF Nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor të OB-ve, Neni 6 - Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore thekson se OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Derisa neni 10, përcakton Strukturën e PFV-ve, dhe ndër të tjera potencon që detyrimet kontingjente janë pjesë e PFV-ve.

Vlera e detyrimeve kontingjente, e shpalosur në PFV të vitit 2022 ishte 250,925€, ndërsa sipas listës së detyrimeve kontingjente në komunë është 243,157€. Dallimi është për arsye se një faturë me vlerë 7,778€ ishte përfshirë gabimisht në regjistrin e detyrimeve Kontingjente, dhe si rezultat i

kësaj ka mbivlerësim për 7,778€.

Gjithashtu, detyrimet kontingjente për pagat jubilarë janë përfshirë në regjistër dhe janë shpalosur në PFV por nuk kanë vlerë monetare.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos mbajtjes së një regjistri adekuat dhe të azhurnuar të detyrimeve kontingjente dhe pakujdesisë së zyrtarëve në krahasimin dhe verifikimin e regjistrave të detyrimeve kontingjente dhe regjistrin e faturave të papaguara.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente shkakton mbivlerësim të tyre dhe mund të ndikojë në vendimet e shfrytëzuesve të informatave të shpalosura në PFV.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së PFV-ve të rishikohen regjistrat e detyrimeve kontingjente dhe detyrimeve/faturave të pa paguara në mënyrë që të shmangen dyfishimet e mundshme dhe informatat të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Dhënia e subvencioneve në kundërshtim me Rregulloren për Subvencionimin e OJQ-ve dhe me kriteret e Thirrjes Publike

Gjetja Rregullorja Mf - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat E Financimit Publik të OJQ-ve, Neni 8.5 përcakton kushtet për themelimin e komisionit. Ndërsa, Neni 10 i Formularit 16 thekson se nëse përfituesi nuk përmbushë detyrimet kontraktuale, do të mohohet e drejta për përfitim në dy (2) vitet e ardhshme.

Po ashtu, sipas thirrjen publike të datës 02.06.2022, ishte kriter që të kualifikuarit për subvencion, të paraqesin dëshmi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Në Thirrjen Publike që ishte e hapur për aplikim nga 02.06.2022-22.06.2022, kemi vërejtur se Komisioni i Vlerësimit ishte themeluar me 27.06.2022, apo pesë ditë më vonë. Sipas thirrjes publike, OJQ-të që kishin përfituar subvencion 8,000€ dhe 1,600€ në vitin 2022, nuk kishin përmbushur kriteret e përcaktuara për raportim nga subvencioni paraprak, përkatësisht nuk kanë raportuar me kohë në lidhje me subvencionet e mëhershme dhe kriterin se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Arsyeja përse ka ndodhur kjo është mungesa e kontrolleve të brendshme ku zyrtarët kanë pohuar se nuk kanë pasur njohuri që duhet të formohet Komisioni i Vlerësimit sa është e hapur Thirrja Publike. Megjithatë, për çështjen e paraqitur, shkaku qëndron si pasojë e mungesës së kontrolleve të brendshme në komunë.

Ndikimi Dhënia e subvencioneve OJQ-ve pa plotësuar kriteret, paraqet rrezik që fondet e dhëna t'u jepen përfituesve jo-meritor e të mos përdorën për qëllimet e duhura.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se fillimisht Komisioni Vlerësues të themelohet në kohën sa janë të hapura thirrjet publike, me që rast të emërohen anëtarë kompetent, në mënyrë që aplikacionet të vlerësohen në pajtim të plotë me Rregulloren e lartpërmendur dhe kriteret e Thirrjeve Publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve tjera**Gjetja**

Ligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022, neni 16 pika 10, 9. Për çdo projekt të ri kapital që shtohet në tabelën 4.2., kërkohet aprovimi paraprak nga Kuvendi Komunal.

Pika 11. Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2., duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Në një rast në vlerë 54,850€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet e projektit për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar. Pra, për projektin Rregullimi i fushave sportive, janë bartur mjetet vetëm me vendim të kryetarit nga projekti kapital “Punimet në ujësjellës për rritjen e kapacitetit të ujit në Letnicë”. Për më tepër, nuk ka aprovim nga Kuvendi Komunal për ridestinim të mjeteve dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në kontrata publike pa mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara.

Ndikimi

Kjo ndikon në prezantime të gabuara të raporteve të progresit fizik dhe financiar të projekteve kapitale dhe rrezikon që buxhetimet e viteve vijuese të bëhen të pa sakta, po ashtu rritë mundësinë e vonesave në pagesa për projektet tjera.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave për investime kapitale për të gjitha rastet, të respektohen shumat dhe kodet e projektit përkatës siç janë të miratuara në ligjin e ndarjeve buxhetore, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e shumave apo të projekteve atëherë të kërkohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Regjistrimi i gabuar i pasurisë si Investime në vijim****Gjetja**

Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimit, procesin e inventarizimit etj.

Në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ kemi identifikuar 72 artikuj të ndryshëm të pasurive, (si renovime, rregullim dhe asfaltim i rrugëve, rregullim i hapësirave gjelbëruese, hartime të projekteve etj), të cilat ishin të regjistruara si pasuri në vijim. Të njëjtat duhej të jenë të regjistruara si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohet zhvlerësimi konform shkallëve të caktuara me rregullore. Këto pasuri janë të blera gjatë viteve 2013 - 2022, vlera e tyre në regjistër të pasurive është 2,348,431€. Më tutje në regjistrin kontabël, janë 295 artikuj të pasurive të pa kategorizuar që janë në Kodin ekonomik 32500- Investime në vijim dhe që përshkrimin e kategorisë e kanë “Të diskutohet kodi ekonomik tek pasuritë“, prej të cilëve 141 artikuj

të ndryshëm si (renovime, rregullim dhe asfaltim i rrugëve, rregullim i hapësirave gjelbëruese, etj) nuk kanë zhvlerësim fare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare dhe të mungesës së zyrtarit për menaxhimin e pasurive pasi zyrtarja e mëparshme e pasurive ka kaluar në një pozitë tjetër dhe tani kjo pozitë ka mbetur e zbrazët.

Ndikimi Mbetja e artikujve të caktuar në regjistrin e pasurive si Investime në vijim ndikon në mos zhvlerësimin e pasurive me kohë dhe mbivlerësimin potencial të vlerës së pasurive.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që janë rishikuar regjistrat e pasurive në mënyrë që të evidentohen të gjitha pasuritë që janë të regjistruara si Investime në vijim e që janë të finalizuara si projekte dhe të pranuar teknikisht. Po ashtu, të bëhen ndryshimet në regjistrin kontabël, në mënyrë që atyre pasurive tu ndryshohet klasa dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas normave të përcaktuara me rregullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

Gjetja Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 thekson se - Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Derisa sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Komuna e Vitisë edhe gjatë vitit 2022 kishte vazhduar me angazhimin e 80 personave me kontrata për shërbime të veçanta për të mbuluar pozita të rregullta, dhe për këto angazhime nuk kishte zhvilluar asnjë lloj procedure, qoftë përmes prokurimit, apo procesit të rregullt të rekrutimit. Shumica nga këta zyrtar punojnë në pozita të rregullta të punës si: në Zyrën e Kryetarit, Drejtorinë për financa, Administratë, Prokurim, Gjeodezi dhe Kadastër, Arsim, Shëndetësi, Bujqësi etj. Të njëjtit janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (përfshirë edhe kontributet pensionale dhe tatimin në pagë).

Angazhimi i punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta jo në pajtueshmëri me rregullat e përcaktuara ishte bërë si pasojë e mos zbatimit të kontrolleve të brendshme, edhe pse ZKA për disa vite ka rekomanduar zbatimin e procedurave të përcaktuara për shërbime të veçanta.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit apo procedurave tjera përkatëse për angazhim të stafit, përveç që përbën shkelje ligjore pasi që eliminohet parimi i transparencës dhe konkurrencës, gjithashtu rritë rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyra të caktuara, e që mund të reflektojë edhe në performancën e tyre në punë.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se do të ndiqen procedura adekuate ligjore me rastin e angazhimit të stafit, në mënyrë që personat e angazhuar do të plotësojnë të gjithat kriteret për pozitat përkatëse, qoftë përmes

Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta, apo në rast të pozitive të rregullta fillimisht të bëhet planifikimi sipas ligjit të buxhetit, e pastaj të zhvillohet proces i rregullt i rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave/obligimeve dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbartimore

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për LMFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Nga testimi i pesë (5) mostra në vlerë gjithsej 208,111€ kemi vërejtur se komuna me vonesë kishte kryer pagesat duke tejkaluar afatin ligjor për pagesë. Vonesat variojnë nga 56 deri në 132 ditë.

Më tutje nga rishikimi i pagesave të obligimeve kemi vërejtur se Thesari ka ekzekutuar pagesa direkt në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë totale prej 852,623€, ku nga këto borxhi kryesor ishte 676,073€, ndërsa 176,550€ tjera ishin për shpenzime procedurale të gjykatës/përmbartimit dhe kamata.

Mos pagesa e obligimeve me kohë sa i përket pagave ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve për shlyerjen e obligimeve të dalura nga kontrata kolektive, derisa tek faturat e paguara me vonesë ka ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi

Hyrja në obligime pa zotimin me kohë të mjeteve financiare , si dhe mos pagesa e faturave dhe obligimeve me kohë e ekspozon Komunën ndaj padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore dhe të kamatave.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vitisë në vitin 2022 në total ishin 946,309€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave, gjobat pyjore dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 238,253€.

Çështja C1 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja

Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë, është identifikuar se më shumë se 1,000 tatimpagues të prezantuar në këtë bazë, nuk kanë të prezantuar numrat personal, të cilët në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë përfitues të disa hershëm nga zbritja e lejuar ligjore.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat personal të tatimpaguesve mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,242,400€ prej tyre në 2022 ishin shpenzuar 3,194,330€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të objekteve sportive/kulturo, parqeve, blerje të pajisjeve si dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja A5 - Zotimi i mjeteve financiare pas pranimit të faturës

Gjetja Sipas rregullës Financiare nr. 01/2013/MF - shpenzimi i parasë publike, neni 22, hapat për procedim të pagesave janë: kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër blerja, raporti i pranimit të mallit apo shërbimit, pastaj behet pranimi i faturës, tutje certifikohet/ekzekutohet pagesa në fjalë.

Nga testimi i pagesave të punëve të kryera të projekteve kapitale, kemi hasur në tri (3) raste të pagesave në vlerë 247,682€ që janë realizuar pa u zbatuar procedurat e duhura. Pra janë pranuar mallra, shërbime dhe faturat para së të behet zotimi i mjeteve.

Rastet kishin të bënin me:

- “Riparime nëpër shkollat e Komunës së Vitisë”;
- “ Rregullimi i rrugëve rurale me zhavor”; dhe
- “Ndërtimi i kanalizimeve në Komunën e vitisë” .

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe hyrjeve në obligime pa siguruar mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara.

Ndikimi Zotimi i mjeteve pas pranimit të faturave, përveç së nuk është në pajtim me kërkesat e rregullës financiare, mund të ndikoj që të pranohen punë të kryera me shumë sesa ka mjete buxhetore, rrjedhimisht mund të krijohen vështirësi dhe vonesa për pagesë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë se ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E-prokurimit

Gjetja Pika 61. Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës se kontraktuesve paragrafi 20.f. i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh “Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Komuna e Vitisë menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës se kontraktuesve nuk e ka mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Sipas Menaxherëve të kontratave kjo ka ndodhur për shkak të trajnimit jo të mjaftueshëm të tyre nga KRPP për përdorimin e E-prokurimit. Megjithatë, vërehet se kjo situatë ka të bëjë me mungesë kontrolli dhe mos përdorim të sistemit pa ndonjë shkak pengues.

Ndikimi

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale me vlerë mbi 1000€ është 85,519,763€, pasurive jokapitale me vlerë nën 1000€ është 368,634€ si dhe e stoqeve 18,316€.

Çështja B5 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe harmonizimit të regjistrit të pasurisë

Gjetja Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, ndër të tjera përcakton si kërkesë edhe procesin e inventarizimit të pasurive dhe harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurive, para përgatitjes së PFV-ve.

Komuna nuk e kishte bërë harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrin të pasurive para përgatitjes së PFV-ve, dhe inventarizimi nuk ishte kryer në pajtim me kërkesat e rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive, pasi që raporti i komisionit të inventarizimit ishte përfunduar me datën 15.03.2023.

Kjo ka ndodhur nga mos zbatimi me konsistencë i kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive nga ana e komisionit të inventarizimit.

Ndikimi Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël ndikon në mungesë të informatave të sakta në lidhje me gjendjen dhe vlerën epasuritë si dhe në prezantim jo të drejtë të informatave në PFV.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive të kryhet në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe të bëhet harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël të pasurive, para përgatitjes së PFV-ve të Komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Vitisë ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me vetëm një (1) anëtarë, i cili njëkohësisht është edhe drejtor i njësisë. Po ashtu Komuna ka të themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KA). NjAB kishte përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor në bazë të të cilit ishte planifikur që të realizohen katër (4) auditime, ndërsa ka kryer vetëm tri (3) auditime.

Çështja B6 - Mangësi në Sistemin e Auditimit të Brendshëm

Gjetja Rregullorja e QRK- Nr 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm Në Subjektin e Sektorit Publik, Neni 5.1.1 përcakton se “Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë milionë euro të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm”. Ndërsa, sipas Procedurës Standarde të Operimit, “Trajtimi i të Gjeturave dhe Zbatimi i Rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm dhe të Brendshëm” të miratuar nga Ministria e Financave, kërkohet që për rekomandimet e dhëna nga NjAB duhet të përgatitet një plan veprimi për zbatimin e tyre, dhe ai plan duhet të monitorohet nga NjAB. Udhëzimi Administrativ Nr.01/2019, Neni 8, përcakton se “Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

Njësia e auditimit nuk ka arritur ta përmbushë planin vjetor të auditimit për vitin 2022 pasi që kishte realizuar vetëm tri nga katër auditimet e planifikuara, ku dy prej tyre mbulonin vetëm vitin 2021, ndërsa një mbulonte vitin 2021 dhe tremujorin e vitit 2022. Në këto raporte janë dhënë 12 rekomandime, nga të cilat tri janë zbatuar, pesë janë në proces dhe tri janë të pazbatuara. Menaxhmenti nuk kishte përgaditur një plan veprimi për implementim të rekomandimeve. Komiteti i Auditimit, kishte mbajtur vetëm dy takime gjatë vitit 2022.

Mos përmbushja e planit vjetor ka ndodhur si pasojë e mungesës së stafit të mjaftueshëm në kuadër të NjAB-së, derisa mos adresimi i rekomandimeve ka ndodhur si pasojë e mos-përgatitjes së planeve të veprimit nga departamentet përkatëse dhe përgatitjes së orarit të përcjelljes së rekomandimeve nga auditori i brendshëm. Ndërsa, për shkak të neglizhencës dhe paqartësisë në lidhje me kompensimin e anëtarëve për angazhim në Komitetin e Auditimit (KA), ishin mbajtur vetëm dy takime gjatë vitit 2022.

Ndikimi Mos përmbushja e planit të auditimit dhe mos përfshirja e aktiviteteve të vitit aktual në auditim mund të ndikojë që mangësitë eventuale të mos identifikohen dhe adresohen me kohë nga menaxhmenti i Komunës. Ndërsa, mungesa e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe orarin për përcjelljen e tyre vështirëson përcjelljen e tyre dhe vlerësimin nëse ato rekomandime po zbatohen. Derisa mos mbajtja e takimeve të rregullta të Komitetit, ndikojnë në mos harmonizimin e veprimeve ndërmjet Kryetarit, NjAB-së dhe departamenteve të audituara në lidhje me çështjet e identifikuar nga auditimi.

Rekomandimi B6 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë burime të mjaftueshme për NjAB-në në mënyrë që plani i auditimit të realizohet në tërësi dhe auditimet të

përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual. Çdo raport i auditimit të brendshëm duhet të pasohet me një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe i njëjti të përcillet sipas orarit të implementimit. Po ashtu Komiteti i Auditimit duhet të mbajë së paku katër takime brenda vitit në mënyrë që të ofrojë kontributin e tij konform obligimeve të përcaktuara me rregullat në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	13,069,495	14,349,507	14,093,620	12,674,794	12,548,840
Grante Qeveritare - Buxheti	12,081,627	12,322,276	12,238,786	11,984,960	11,686,792
Financimi përmes huamarrjes	0	89,866	89,866	29,091	82,934
Të bartura nga viti i kaluar	0	682,850	643,369	71,516	143,324
Të hyrat vetanake	987,868	987,868	871,328	589,227	613,442
Donacionet vendore	0	46,203	31,153	0	3,960
Donacionet e jashtme	0	220,444	219,120	0	18,389

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,280,012€. Kjo rritje është si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë në vlerë 240,649€, bartjes së të hyrave nga viti i kaluar në vlerë 682,850€, donacioneve të jashtme në vlerë 220,444€, donacioneve të brendshme (participimeve të qytetarëve) 46,203 dhe mjeteve nga financimi përmes huamarrjes në vlerë 89,866€.

Në vitin 2022 OB ka shpenzuar 98% të buxhetit final, me një rritje prej rreth 4% në krahasim me vitin 2021.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	13,069,495	14,349,507	14,093,620	12,674,794	12,548,840
Pagat dhe mëditjet	7,618,305	7,949,702	7,938,162	8,211,491	7,575,624
Mallrat dhe shërbimet	2,092,704	2,269,154	2,230,790	1,674,384	1,740,445
Komunalitë	320,000	320,000	271,625	235,921	303,997
Subvencionet dhe transferet	360,000	568,251	458,713	251,801	251,600
Investimet Kapitale	2,678,486	3,242,400	3,194,330	2,301,197	2,677,175

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje kishte rritje në krahasim me buxhetin fillestar në vlerë 331,397€. Kjo rritje ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë në vlerë 241,531€ për shtesa në paga për punëtorët e sektorit shëndetësor dhe të Arsimit, si dhe alokimit të mjeteve nga Fondi i huamarrjes në vlerë 89,866€ për pagesën e pagave jubilarë dhe përcjellëse. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte pothuajse 100%;
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 176,450€. Rritja ishte si rezultat i bartjes së të hyrave vetanake. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 98%;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar derisa realizimi në këtë kategori ishte 85%;
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 208,251€, si rezultat i bartjes së të hyrave vetanake në shumë prej 162,049 €, dhe donacioneve në shumë prej 46,202€ participim i qytetarëve për projektet e bujqësisë. Realizimi në këtë kategori në fund të vitit ishte 81%; dhe
- Buxheti final për Investime Kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 563,914€. Fillimisht kishte rritje të buxhetit nga të hyrat vetanake në vlerë 344,777€, , dhe nga donacionet 219,137, donacione të vitit 2022 nga DEMOS-i - granti i performancës, me të cilin është financuar projekti „Rregullimit të rrugës Flaka e janarit " Realizimi në këtë kategori në fund të vitit ishte 99%.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2022, për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 97,298€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në shëndetësi, shërbimi i kujdesit primar shëndetësor.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vitisë në vitin 2022 në total ishin 946,309€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave, gjobat pyjore dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 238,253€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	987,868	987,868	946,309	936,236	623,749
Të hyrat tatimore	592,320	592,320	527,963	475,146	331,346
Të hyrat jo tatimore	395,548	395,548	418,346	457,718	292,403
Të hyrat tjera	0	0		3,371	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar, një (1) është zbatuar pjesërisht dhe gjashtë (6) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari dhe vartësit e tij duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për identifikimin e të gjithë përfituesve të disahershëm të zbritjes së vendbanimit parësor, t'i korrigojnë të dhënat në sistem dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat ligjore, për eliminimin e këtij problemi.	Komuna ka arritur të zbatojë pjesërisht rekomandimin, ku sipas mostrave të testuara nuk kanë rezultuar raste me të përfituesve të disahershëm të zbritjes së vendbanimit parësor. Ndërsa, ende vazhdojnë mangësitë në bazën e të dhënave të tatimit në pronë për numrat personal të tatimpaguesve.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që përfituesit të përfitojnë subvencione vetëm njëherë brenda vitit ashtu siç është përcaktuar me rregullore. Ndërsa për çdo subvencionim të OJQ-ve që kualifikohet për t'u trajtuar sipas Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve, të shpallet Thirrje Publike dhe të aplikohen kërkesat që rrjedhin nga e njëjta.	Komuna ka ndaluar subvencionimin e OJQ-ve përmes vendimeve me shumë mbi 500 euro. Ndërsa, subvencionet në Bujqësi janë dhënë në pajtim me rregulloren dhe thirrjet publike.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të zbatohen me përpikëri kërkesat ligjore në lidhje me disponueshmërinë dhe zotimin e fondeve, përgjatë procesit të zhvillimit dhe përmbylljes së procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave.	Nga mostrat e kontrolluara në këtë vit nuk kemi hasur çështje të tilla.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Komuna ka adresuar rekomandimin.	I zbatuar

5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit për angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Pozitat e rregullta duhet të planifikohen me Ligjin e Buxhetit dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes procesit të rregullt të rekrutimit.	Rekomandim i pa zbatuar. Menaxhmenti nuk ka ndërmarr veprime për të ndryshuar gjendjen pasi që ka vazhduar me të vjetrën duke angazhuar punëtorë të rregullt me MSHV duke mos zhvilluar asnjë lloj procedure.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se vartësit e tij që janë pjesë e komisioneve të vlerësimit, me rastin e vlerësimit të aplikacioneve fillimisht duhet t'u përmbahen kriterëve të shpallura në thirrje publike, si dhe të respektojnë të gjitha kërkesat e aplikueshme të përcaktuara me Rregullore komunale të subvencionëve.	Ky rekomandim është zbatuar.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që kohëzgjatja e sigurisë së tenderit në të gjitha rastet të jetë e vlefshme deri në nënshkrimin e kontratës. Në rastet kur nënshkrimi i kontratave vonohet, duhet të kërkohej nga OE që të zgjatet vlefshmëria e sigurisë së tenderit për aq kohë sa është e nevojshme.	Nga rishikimi i mostrave të auditimit të vitit 2022 nuk kemi hasur në raste të tilla prandaj kemi konkluduar se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që janë rishikuar regjistrat e pasurive në mënyrë që të evidentohen të gjitha pasuritë që janë të regjistruara si Investime në vijim e që janë të finalizuara si projekte dhe të pranuar teknikisht, të bëhen ndryshimet edhe në regjistrin kontabël në mënyrë që atyre pasurive tu ndryshohet klasa dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas normave të përcaktuara me rregullore.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin

9.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive të kryhet në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe të bëhet harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël të pasurive, para përgatitjes së PFV-ve të Komunës për vitin 2022.	Rekomandim i nuk është zbatuar, pasi edhe kete vit nuk ishte bërë harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrin të pasurive para përgatitjes së PFV-ve, dhe inventarizimi nuk ishte kryer në pajtim me kërkesat e rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive pasi nuk i ka përfshirë komplet pasuritë e Komunës.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme dhe veprimet konkrete për mbledhjen e LI.A, duke marrë në konsideratë çdo masë në dispozicion për mbledhjen e borxheve. Po ashtu, të merr masa të menjëhershme ndaj shfrytëzuesve të pronës komunale që nuk paguajnë obligimet financiare duke kthyer pronat në përkujdesje të Komunës, në mënyrë që t'u jepet shfrytëzuesve të përgjegjshëm.	Ky rekomandim është zbatuar pasi është konfirmuar se Komuna ka ndërmarr masa për inkasimin e borxjeve duke i dërguar në përmbarrim borxhlinjë.	I zbatuar
11.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarrimit.	Rekomandimi nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së PFV-ve të rishikohen regjistrat e detyrimeve kontingjente dhe detyrimeve/faturave të pa paguara në mënyrë që të shmangen dyfishimet e mundshme dhe informatat të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV.	Rekomandimi nuk është zbatuar. Edhe këtë vit kemi evidentuar se ishte bërë mbivlerësimi i detyrimeve kontingjente.	Nuk ka filluar zbatimi

13.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë burime të mjaftueshme për NjAB-në në mënyrë që planet e auditimit të realizohet në tërësi dhe auditimet të përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual. Çdo raport i auditimit të brendshëm duhet të pasohet me një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe i njëjti të monitorohet në baza të rregullta kohore. Po ashtu KA duhet ti mbajë me rregull takimet në mënyrë që të ofrojë kontributin e tij konform obligimeve të përcaktuara me rregullat në fuqi.	Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në zbatimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
-----	----------------------	---	---	-------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Xhevat Seferi, Udhëheqës i ekipit



Gazmend Namani, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike</p>	<p>Sipas opinionit të ZKA-së e bazë për opinion të kualifikuar është Klasifikimi i shpenzimeve jo adekuate të ekzekutuara nga Thesari i shtetit për pagesën e pagave jubilarë të punëtorëve arsimor të shpenzuara në kategorit tjera ekonomike (Jo paga e shtesa) të ekzekutuara në fund të vitit me datë 25.11.2022 dy pagesa, 29.11.2022 gjashtë pagesa dhe më datë 10.12.2022 një pagesë.</p> <p>Ne si Komunë nuk kemi pasur njohuri dhe nuk jemi kontaktuar për ekzekutimin e këtyre lëndëve që kanë rrjedhur në bazë të kontratës kolektive të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës pa krijuar mbulesë buxhetore për mbulimin e këtyre shpenzimeve dhe gjat planifikimit të buxheteve nuk jemi lejuar nga departamenti i buxhetit për sigurimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të kontratës kolektive.</p> <p>Në mamentin kur padit e punëtorëve arsimor kan marrë formën e prerë nga gjykata dhe janë dorëzuar në Thesarin e shtetit departamenti i pagesave ka bërë ekzekutimin e këtyre lëndëve në kategorit jo adekuate.</p> <p>Komuna e Vitisë e konsideron shumë të pa drejtë marrjen për bazë për opinion të kualifikuar këtë të gjetur, andaj kërkojmë që baza për opinion të auditimit të mos merret parasysh veprimet jo të drejta të departamentit të thesarit që janë bërë për shpenzime jo adekuate në buxhetin e Komunës së Vitisë.</p>	<p>E gjetura qëndron, ndonëse pagesat janë ekzekutuar nga Thesari, në PFV-të e Komunës së Vitisë, në bazë të dëshmimeve, shpenzimet nuk janë paraqitur saktë dhe drejtë për shkak të keqklasifikimit të tyre.</p>

<p>Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PFV</p>	<p>Për pronat publike dhe shoqërore, të dhënat janë të importuara nga Departamenti i tatimit në pronë e të cilat të dhëna janë të marra nga Agjensioni Kadastral i Kosovës dhe janë të përkthyer nga Departamenti i tatimit në pronë dhe deri më tani mund të ketë pasur paqartësi për ndonjë pronë që është publike e në kundërshtim me Ligjin që i nënshtrohet tatimit në pronë. Edhe pse nuk është kompetencë e Zyrës së tatimit në pronë, ne do të identifikojmë një nga një këto raste dhe do të bëjmë përmirësimet e nevojshme në regjistrat e tatimit në pronë në kordinim me Departamentin e Tatimit në Pronë - Prishtinë. Ndërsa për pronat e ish ndërmarrjeve shoqërore e që brenda kohës janë bërë publike ose private do të vërtetojmë një nga një statusin juridik të tyre dhe do të bëjmë ndryshimet e nevojshme në regjistrat e tatimit në pronë. Kjo pa rregullsi është në tërë Komunitat e Republikës së Kosovës.</p>	<p>E gjetura qëndron për faktin se LI.A janë mbivlerësura në PVF të Komunës. Komuna ka dhënë sqarimet dhe arsyetimet mbi gjetjen e auditorit dhe ka treguar masat që ndërmerr për Korigjimin e regjistrit të LI.A.</p>
---	--	--



Komuna e Vitisë



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë dhe jo pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vitisë, për vitin 2022 .
- Nuk pajtohem me dy gjetjet (A1 dhe A2) - Baza për opinion të kualifikuar që të dy të gjeturat që janë veprime direkte të MFPT një e Departamentit të Thesarit (ekzekutimi i pagesave të pagave jubilarë – **klasifikimi i shpenzimeve ne kategori joadekuate** dhe tjetra e Departamentit të Tatimit në pronë **llogarië e arkëtueshme të mbivlerësuar**) janë dy gjetjet bazë për kualifikim të raportit dhe në RVF në komente janë të paraqitura si lëndë të ekzekutuara nga thesari (faqe 21, 23 dhe 26) edhe përkundër konfirmimit tonë se duhet të ekzekutohen në kategorinë e pagave dhe shtesave, të ekzekutuara në fund të muajit nëntor tetë lëndë me datë 25.11.2022 dy lëndë dhe 29.11.2022 gjashtë lëndë dhe një në fillim të muajit dhjetor të datës 10.12.2022 dhe rekomandimeve tjera komentet do tju bashkangjesim .
- Mbrenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre përveq dy të gjeturave A1 dhe A2 që janë veprime të zyrtarëve të MFPT që nuk do të kemi ndikim në veprimet e tyre dhe neve na dalin në raport si Klasifikime jo adekuate A1 dhe llogari të mbivlerësuar A2.

Z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës

Data: 06.05.2023, Viti*



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.